

DEKLARATË NGA KOALICIONI TË DREJTAT E BARABARTA PËR TË GJITHË

Dënim i deklaratave të bëra nga deputeti Kelmendi dhe thirrje për masa disiplinore ndaj tij nga Kuvendi i Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndalon diskriminimin ndaj qytetarëve në një shumë çështje, duke përfshirë këtu orientimin seksual. Kushtetuta gjithashtu një numër të të Drejtave Themelore, siç janë e Drejta për Liri dhe Siguri, Liria e Tubimit, dhe Liria e Asociimit. Të gjitha këto të drejta janë ushtruar nga qytetarë të Republikës kur disa prej tyre organizuan një marshim paqësor për festimin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Homofobisë dhe Transfobisë në Prishtinë, më 17 maj, marshim në të cilin morrën pjesë qindra pjesëmarrës, duke përfshirë këtu udhëheqës politikë dhe ambasadorë. Marshimi u organizua në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kishte mbështetjen logjistike dhe të sigurisë nga ana e institucioneve relevante, duke përfshirë edhe Policinë e Kosovës.

Më vonë, deputi i pavarur Gëzim Kelmendi (i cili është gjithashtu udhëheqës i partisë politike Fjala), deklaroi se “populli jonë nuk ka nevojë për parada të tilla të komunitetit LGBT” dhe se “shkencërisht është e vërtetuar se "homoseksualizmi" është sëmundje”, si dhe se e gjithë kjo është kundër vlerave të familjes. Ai gjithashtu deklaroi se “kjo sëmundje sot është ndër shkaktarët kryesor të shkatërrimit të familjes dhe zvogëlimit të numrit të popullsisë”.

ERAC shfrytëzon rastin që të përsërisë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve të Republikës, pa dallim orientimi apo (vetë)identifikimi seksual të tyre. Këto të drejta nuk mund të shkurtohen apo të cungohen me argumentin fals se këto të drejta rrezikojnë vlerat familjare, në veçanti kur këso lloj deklaratash vijnë nga zyrtarë publikë apo të zgjedhur.

Të qenurit homoseksual apo heteroseksual e një qytetari nuk ka kurrfarë efekti në vlerat familjare dhe një person që është homoseksual nuk i rrezikon apo shtrembëron këto vlera as më shumë e as më pak se një person heteroseksual. Për më tepër, e drejta për tubim dhe asociim paqësor nuk mund të shkurtohet dhe kufizohet për ato shkaqe që konsiderohen “të denja”, po ajo e drejtë iu jipet të gjithë qytetarëve dhe të gjitha komuniteteve, për aq sa ata veprojnë brenda kufijve të ligjit.

Zoti Kelmendi mban një post publik dhe si i tillë mban edhe përgjegjësi për respektin e vlerave dhe principeve të Kushtetutës. Deklarato si kjo e dhënë nga z. Kelmendi mund të nxisin dhunë, shembuj të të cilave ne kemi parë në vitin 2012 kur një grup prej 30 personave sulmoi anëtarë të



komunitetit dhe mbështetës të tyre. Argumente të ngjajshme për “vlerat familjare” dhe “tradita” u përdorën edhe atëherë për të arsyetuar sulmet që demoluan ndejën e organizuar dhe lanë një person, pjesëmarrës në organizim, të lënduar. Komuniteti ka qenë gjithashtu cak i sulmeve të ngjajshme—ndonëse më të vogla—në të kaluarën.¹

Ne i bëjmë thirrje Kuvendit të Kosovës, anëtar i së cilit është z. Kelmendi si deputet i zgjedhur dhe rrjedhimisht detyrohet t’i përmbahet Rregullores së Punës së tij, po edhe Komisionit të Kuvendit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione, të marrin në konsideratë këtë çështje dhe të denojnë fuqishëm deklaratat e bëra nga z. Kelmendi, si dhe të hetojnë nëse këto deklarata përbëjnë gjuhë të urrejtjes duke u bazuar në ligjet e Kosovës.

Shënim

Koalicioni “**Të drejta të Barabarta për të Gjithë**” përbëhet prej **7 organizatave jo-qeveritare** të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njerit duke u fokusuar në grupet e marginalizuara dhe të cënuara sic janë **komunitete pakicë, komuniteti LGBT, gratë dhe rinia**. Anëtarët e Koalicionit “Të drejta të Barabarta për të gjithë” janë: **Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore (QZhGSh), Qendra për Barazi dhe Liri të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL), Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR KS), Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD) dhe Glocal Kosova.**

¹ <http://www.queerty.com/u-s-embassy-condemns-series-of-violent-anti-gay-attacks-in-kosovo-20121218>

